



Prishtinë, 18 korrik 2012  
Kodi i ZRRE-së: V\_436\_2012

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

**në seancën e mbajtur me datë 18 korrik 2012 nxori këtë:**

## VENDIM

- I. MODIFIKOHET Licenca për Gjenerim të Energjisë Elektrike (me kushte)** e dhënë ndërmarrjes N.P Ibër–Lepenc me numër licence ZRRE/Li\_17/06, e cila ka qenë e vlefshme nga data 04.10.2006 deri 04.10.2026.
- I. Licenca e modifikuar (tani e tutje “Licencë për Prodhim të Energjisë Elektrike”) me numër ZRRE/Li\_17/12 do të hyjë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi dhe do të jetë e vlefshme deri me **04 Tetor 2026**. Obligohet N.P Ibër–Lepenc që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për gjenerim të energjisë elektrike për ndërmarrjen N.P Ibër–Lepenc, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 04.10.2006. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
- Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e interesuara. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të interesuara dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
- Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*\*Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar